Vdekje fashizmit — Liri popullit

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguame

NEDELJNI LIST
FLETORE E PERJAVSHME

Redaksija: Prishtinë
Rruga Armata e Kuqe Nr. 2

PAJTIMET
për 1 vit 96 din
„ 6 muej 48 „
„ 3 muej 24 „

Dorëshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik
Drejtori pergjegjës XHELADIN HANA

Vjeti IV Nr. 101

PRISHTINE, 31 Kallnuer 1948

Çmimi 2 dinarë

Nga Kongresi i Dyte i Frontit Antifashist te Grues te Jugosllavis

Fjalimi i Marshalit Tito ne Kongres

Ardhmenija e jonë ma e bukur s'mund të jetë tjeter veçse veper e duerve t'ona, perpjekieve t'ona mendore dhe fizike, ashtu sikur edhe lirija e jonë ka ardhë si rezultat i luftés mbinjerëzore dhe flijimeve te popujve t'onë

Marshali i Jugosllavis JOSIP BROZ—TITO

Të dashtunat shoqe!

Me lejoni edhe mue t'a përshendes ket kongres t'uejin dhe, n' emen të Qeveris së RFRJ e të Frontit populluer të Jugosllavis të ju uroj punë të mbarë në kryemjen me sukses të detyrëve t' ueja të randa të paskëtajme.

Kongresi i juej i Dytë po mbahet në nji kohë kur ka marrë hov të plotë puna krijuese në ndertimin e Vendit t' one, puna në krijimin e ardhmenis ma të bukur për popujt t' onë, per realizimin e socjalizmit në Vendin t' one. Ne ket kongres keni me muejtë me i konstatue me krenari sukseset kolosale, qe i kanë mbrrijte popujt t' one qysh nga kongresi i juej i kaluem dhe me thanë me ballë çelë se në këto përpjekje dhe rezultate kolosale grat e Jugosllavis e kanë dhanë ndihmen e tyne të çmueshme, me thanë se kjo asht edhe nji pjesë e madhe e përpjekjeve të femnave t' ona të vetedijshme.

Shoqe! Ju me të vertetë keni se me çka të dilni perpara këtij kongresi t'uej. Na e dijmë ktë, por keto suksese të mdhaja mos të jenë shkak që juve të deheni nga ato, të ju mbushet mendja se e keni mbrrijte kulmin, me gjithse keni per shka të mburreni. Jo, ky kongres i juej i le të ju jetë nji nxitje për zhdukjen e shum të metave që ende egzistojnë n' organizaten t' uej, në punën t' uej. Ketu duhet të paraqiten të gjitha sukseset, por edhe të gjitha të metat keshtu do të mundeni me i zhduhë kito të fundit ma lehtë.

Ne sukseset e deritashme te mbrrijtuna ne rindertimin e Jugosllavis se rrenueme gratë kane marre pjese te gjane

Unë kam pasë sa e sa herë rastin me theksue rrolin shum të madh që kanë luejtë femnat t' ona të përparueme në kohen e luftes së madhe çlirimtare të popujve t' one, me thekësue heroizmin — të pashembullt në historin e popujve t'one, — heroizmin e femnave t'ona; e tasht po përfitoj nga kjo rasë që t'a thekësoj rolin shum të madh të femnave t'ona ne ndertimin e Vendit t'onë, t'a veje në dukje kontributin e çmueshem që japin grat e Jugoslavis për realizmin e Planit t'onë pesvjeçar. Me këte due të them se ne sukseset e deritashme të mbrrijtuna në rindertimin e Jugoslavis se rrenueme grat kanë marrë pjese te gjanë, ato edhe në ndertimin e Vendit t' one janë tregue në nji naltesi shembullore.

Për kend mendoj kur flas për femnat e përparume të Jugoslavis? Mendoj për femnat luftëtare, që me pushkë në dorë luftuen për lirin e popujve t' one në luftën çlirimtare ose punuen në mbrapavije e që tashti me të njajtin vetmohim, punojnë nder fabrika, ara, ose në çfardo pune tjeter të randësishme per kolektivitetin t'one. Un mendojë se ato femna të vetmohueshme që punojnë me kujdes nëpër fabrika e sipërmarrje të ndryshme janë te vetedijshme qe punoinë jo vetem për vehte, por për mbarë kolektivitetin t'one popullor, nuk kursejne djersen e tyne, si e si ndihma e vet për ket kolektivitet të jetë sa ma e madhe. Këtu mendoj për ato femna të katundeve të cilat punojnë me kujdes nder arë, si e si t'i punojnë sa ma mirë e sa ma me ndergjegje tokat e veta e të nxjerrin sa ma shum prodhime jo vetem ne dobin e tyne por edhe në dobi të mbarë kolektivitetit. Mendoj në nanat, grate dhe motrat e shumta që në luften çlirimtare e dhanë driten e syve të vet, bijt e bijat e veta, i dhane burrat dhe vllaznit e vet, e që nuk ankohen për keto flijime të mdhaja por krenohen me to. Mendoj per të gjitha ato femna që japin kontributin e tyne për të miren e mbarë kolektivitetit t' one, e jo vetem për vehte, kudo qe punojnë — nder zyra, shkolla ose në ndonji punë tjeter. Mendoj për te gjitha ato gra që e duen Jugosllavin e re e që ket dashunni të tyne e çiaqin në nji punë ose tjeter të dobishme, në të miren e popullve t' onë. Këto janë grate e perparueme, antifashiste me punë e jo me fjale. Këtu hyn shumica dermuese e femnave t' ona të perparueme, të cilat janë të vetëdijshme për rrolin e tyne të madh në shoqnin t'one të re, që jane të vetedijshme për detyren dhe përgjegjesin e vet ndaj kolektivitetit popullor.

Qe, të gjitha këtyne femnave e konsideroj si detyrë t' imen t'u shprehe falendermin e mirënjoftjen t'ime, tue dishrue që t'a vazhdojnë edhe ma vendimtarisht punen e tyne per të miren e Republikes s'one Federative Popullore të Jugosllavis.

Kurre dhe asnjeni nuk ka te drejte me thane se ka dhane mjaft nga vehtja per kolektivitetin, ne qofte se asht fizikisht dhe menderisht i afte te punoje edhe ma.

Por, me lejonit t'u hjedhi dhe nji sy kritik disa te metave dhe dobesinave, si ne punën e udheheqësive të kesaj organizate të madhe të grues, ashtu edhe përsa i përket qendrimit të nji pjese, natyrisht nji pjese te vogel të grave te cilat nuk jane të vetëdiishme për detyren e tyne ose mbajne nji qëndrim indiferent ndaj kolektivitetit. Këtu un nuk mendoj per atë numer te vogel zonjash dhe zonjushash të ndryshme neper qytete, qe nuk e duen Jugosllavin e re, qe jane nen influencen e amiqve te Jugoslavis se re, për të cilat asht e pakuptueshme dhe e huej kjo jete e vrullshme krijuese në Vendin t'one, mendoj per ate pjesen tjeter të vogel të femnave që mendojne se gjate luftes kanë dhane mjaft nga vehtja per Jugoslavin e re, qoft ne lufte qoft ne punen e mbrapavijes e tashti nuk marrin pjesë as ne punimet e ndryshme ne dobi te popullit as ne jeten shoqnore, por e keqyrin punen e vet. Ne ket menyre, keto gra bijne pak nga pak ne radhen e atyne femnave qe nuk e perqafojne shoqnin e re, por lakmojne me jetue ashtu lehte, me jetue ashtu pa u-lodhe e pa punue. Shpesh keto gra i marrin huqet e grave pertace te shoqnis se vjeter. Kurre dhe asnjeni nuk ka te drejte me thane se ka dhane mjaft nga vehtja per kolektivitetin, ne qofte se asht fizikisht dhe menderisht i afte te punoje edhe ma. Ketu baj perjashtim per grate qe janë të zanuna shum me kujdesimin për femijt, mbassi edhe kjo asht pune shoqnore. Ketu mendoj t'a thekësoj faktin se ka shoqe, te cilat në lufte jane tregue mirë, por tashti në paqe nuk marrin pjese në jeten shoqnore, d. m. th. ne punen politike dhe krijuese për kolektivitetin. Kjo asht punë e padrejte dhe e damshme jo vetem per kolektivitetin, por edhe per ato vet, sepse në kete mënyre ato tëhuejen nga shumica dermuese e femnave t' ona, qe kane kuptue frymen e Jugoslavis se re dhe detyret e veta. Gjithashtu, ka jo pak gra qe rrijne te veçueme nga jeta e re, jo sepse ato nuk e duen Jugoslavin e re, por sepse ende nuk jane të vetedijshme per detyret dhe te drejtat e tyne te reja ne Jugosllavin e re. Por, ketu duhet te thekesoj se nuk jane vetem ato fajtore per kete. Nji pjese e madhe e fajit per kete i takon punes se dobet te disa udheheqesinave t' organizatave te grues, qe nuk ia kushtojne kujdesin e duhun punes me keto gra, aktivizimit te tyne politik ne pjesemarrjen, ne perpjekjet e pergjitheshme per ndertimin e Vendit t'one.

Ju nuk duhet te ju dhimbet mundi ne punen t'uej per zgjimin e vetedijes te ato gra te cilat sot ende rrijne me nji ane

Ndokush, ndoshta, do te kujtoje se kjo kritike asht teper e ashper dhe e pa-merituene. Por, nuk asht ashtu. Kjo kritike asht krejt me vend dhe shoqet duhet t'a kene parasysh. Po, asht e vertete, grate marrin pjese ne punen e Frontit populluer nder shum raste, bile numerikisht edhe ma shum se sa mashkujt. Na shofim shpesh nder punimet e ndryshme shum ma teper gra çka meriton çdo lavdate. Por, duhet te pranojme se kesaj pune i shmanget nji numer jo i vogel grash, çka asht per t'u qortue, mbassi nji gja e ketille nuk i ka hije grues se re te Jugosllavis se re.

Shoqe të dashtuna!

Fronti Antifashist i Grave të Jugosllavis paraqet jo vetem nji organizatë të fortë të grues në vetvede, por kjo organizatë asht nji faktor i fuqishem, në çdo pikëpamje, në Frontin Populluer të Jugosllavis, nji nga shtyllat e tij ma te forta. Prandaj, aq ma e madhe asht edhe përgjegjësija e juej për forcimin e zhvillimin e matutjeshem të kësaj organizates s'uej, përgjegjësija për punën politike, kulturale dhe të gjithanëshme me gratë.

Para nesh shtrohen detyrë shum të mdhaja edhe të vështira, e kur them para nesh, atëhere kjo u përket në mënyrë të veçantë edhe grave t'ona, organizates s'uej, e cila, tue i përfshi të gjitha gratë patriotike dhe tue i aktivizu ato në mënyrë të gjithanëshme, duhet të kontribuoj sa ma tepër të jetë e mundun në përpjekjet t'ona të përgjithshme për realizimin e qellimeve që, kur të plotsohen, do t'iu sjellin lumnin dhe mirëqenjen popujve t'onë, fëmijve t'onë, breznive t'ona t'ardhëshme. Ju nuk duhet të ju dhimbet mundi në punen t'uej për zgjimin e vetëdijes te ato gra të cilat sot ende rrijnë më nji anë, në vend që të bahen pjesëmarrëse aktive në ket transformin historiko-shoqnor t'onin, në këto përpjekje vigane për realizimin e Planit t'onë pesvjeçar, për ndertimin e Vendit t'onë — si e si të bahet, nga vendi i mbrapambetun, në njenin nga ma të përparuemit në botë, në çdo pikëpamje.

Shoqe, ardhmenija e jonë ma e bukur s'mund të jetë tjetër veçse vepër e duerve t'ona, përpjekjeve t'ona mendore dhe fizike, ashtu sikur edhe lirija e jonë ka ardhë si rezultat i luftes mbinjerëzore dhe flijimeve të popujve t'onë. Se shka mund të bajnë popujt t'onë për t'a realizue ket ardhmeni ma të mirë, këte ata e kanë tregue deri tash në nji përjudhë shum të shkurtë ç'prej mbarimit të luftes, tue mbrri aso rezultatesh me ndertimin politik dhe ekonomikt të Vendit, që e habitin boten.

(Vazhdon ne faqen e dytë)

Nga fjalimi i Marshalit Tito

Per kryemjen e detyreve t'one na duhet te pshtetemi vetem ne vehtvehte, ne fuqit t'ona, pike se pari, mandej ne bashkpunimin ekonomik vllaznuer me Bashkimin Sovjetik dhe Vendet e tjera mike

(Vijim nga faqja e parë)

Shoqe, sot nuk do të flas këtu mbi politiken e jashtme, me gjithse kishem me pasë shum e shum për të thanë, vetem do t'i përmendi me ketë rast disa gjana që na tregojnë qjartazi sa i saktë asht konstatimi i jonë se me realizimin e detyrëve t'ona ne orjentohemi, pikë së pari, në vet forcat t'ona, në punen e vetmohueshme të Rinis s'onë, të puntorëve e puntoreve t'ona nder fabrika dhe sypërmarrje të ndryshme, në punen e vetmohueshme të katundarëve t'onë nder ara, në punen e inteligjences s'onë popullore nder institutet, shkollat dhe sypërmarrjet e ndryshme. Po shiqoni njiherë rreth vehtes çka do të shifni? Në nji anë keni me i pa Vendet demokratike këtu në lindje e në jug-lindje, me Bashkimin Sovjetik në krye, shumica e të cilave asht damtue tmerrësisht në luftë nga okupatorët fashista gjermanë e italjanë. Dhe sot popujt e këtyne Vendeve, me përpjekje mbinjerëzore, ndertojnë Vendet e tyne të rrenueme nga lufta, luftojnë vendosëmenisht për paqë, sepse ajo u asht e domosdoshme për shërimin e plagëve që u ka shkaktue lufta. Nga ana tjeter do të shifni klikat financjare reakcjonare të disa fuqive të mdhaja, atje në Prendim, vendet e të cilave janë damtue shum ma pak, mund të thuhet pakrahasueshmenisht ma pak, në luftë, e me gjith këte këto klika nuk janë të knaquna me rezultatin e luftes, sepse nuk e kanë ngi apetitin e vet imperjalist. Këto klika tashti përseri e kërcnojnë paqen. Provokojnë dhe pregatiten për luftë, tue u ndihmue me të gjitha mjetet anmiqëve të deri-djeshem të popujve të bashkuem në luftë—fashistave gjermanë, italjanë, françezë etj. Këto klika nxitëse të luftes na mënijnë me gjithë shpirt. Ata e urrejnë punen t'onë krijuese, sukseset t'ona, zhvillimin t'onë paqësuer, fuqin t'onë, e cila qëndron në bashkimin dhë vendosmenin t'onë. Këto klika nuk e kanë aspak për turp të na grabisin ose të na cungojnë ate që asht e jona dhe e nji nevoje jetësore për popujt t'onë. Këto klika duen të na cungojnë edhe atë minimalen, çka asht caktue tash ma njiherë nder foramet nderkombëtare si dam-shpërblim për Vendin t'onë të rrenuem pa masë në luftë, duen me na i zvoglue reparacjonet e restitucjonet.

Do të pyetni: me ç'farë të drejte? Për këta zotnij nuk ka kurrfar morali në ketë pikëpamje, e pra as kurrfar të drejte. Ata janë në gjendje me gjetë njiqind pretekste të ndryeshme, natyrisht cinike, vetem si e si t'i mbrijnë qellimet e tyne grabitçare imperjaliste. Nga kjo anë, shoqe të dashtuna, mos pritni kurrfar ndihme, por vetem të keqe dhe dam. Për kryemjen e detyrëve t'ona na duhet të pshtetemi vetem në vehtvete, në fuqit t'ona, pikë së pari, mandej në bashkpunimin ekonomik vllaznuer me Bashkimin Sovjetik dhe Vendet e tjera mike. Për zhvillimin t'onë paqësuer ne mund të pshtetemi në miqësin e pashkatrrueshme dhe mprojtjen e aleatit të madh Bashkimit Sovjetik, në miqësin e pa-shkatrueshme me të gjitha Vendet këtu në Lindje, me të cilat na lidhin interesat e përbashkëta, përsa i përket bashkpunimit të gjithanëshem dhe zhvillimit paqësuer. Ne mund të mbështetemi gjithashtu edhe në të gjitha fuqinat demokratike të botes, të cila' po kështu, i urrejnë provokatorët e luftes, që urrejnë luften po ashtu sikurse e urrejnë edhe popujt t'onë këtu.

Detyret qe shtrohen para femnave t'ona

Shoqe, un nuk do të flas këtu hollësisht mbi detyret t'ueja. Ju, përgjithësisht i dini, kjo asht punë e kongresit t'uej. Por, më lejoni që t'ia paraqes ndërgjegjes s'uej, si detyrë shum të randësishme: kujdesimin për fëmijt, për brezin e ri. Nuk mjafton që fëmija të vishen, ushqehen etj. Për ne ka randësi edhe kjo: këta fëmij edhe t'edukohen si duhet në frymen e Jugosllavis së re. Mos leni që anmiqët e Jugosllavis së re të na helmatisin dhe të na tëhuejin fëmijen t'onë. Rueni fëmijen t'onë dhe kujdesohuni për t'a që të mund të bahen për njimend qytetarë të denjë të Jugosllavis s'onë të re, qytetarë të Vendit të ri të socjalizmit. Kjo asht nji nga detyret t'ueja ma të randësishmet. Se si do t'a bani ju këte, kjo asht punë të cilen do t'a zgjidhni këtu në kongresin t'uej.

Detyrët e tjera të randësishme t'uejat janë: pjesëmarrja e juej e plotë dhe përpjekja e gjithanëshme për realizimin e Planit t'onë pesvjeçar, përpjekja e juej për likuidimin e plotë t'analfabetizmit në Vendit t'onë, pjesëmarrja e juej në punen e organeve popullore etj.

Detyrë e randësishme e organizates s'uej asht edhe lufta e vendosun për përforcimin e paqes. Në kryemjen e kësaj detyre ju lidhuni me të gjitha organizatat përparimtare të grues jashta kufijve t'onë. Pikërisht gratë ma tepër se kushdo, kanë të drejtë të marrin nji qendrim të vendosun kundra të gjithë nxitësave të luftes, anmiqëve të paqes. Gratë, nanat, që e kuptojnë se çka donë me thanë me i humbë ma të dashtunit e vet në luftë, ç'ka donë me thanë rrenimi i vendit, ato janë që duhet t'i urrejnë ma së forti shkaktaret e luftes. Kjo urrejte kundra nxitësave te luftes le të jetë nji kontribut i fortë për përforcimin e paqes në botë. Urrejtja kundra nxitësave të luftes duhet të jetë ajo forcë, e cila do t'a bajë të mundëshem bashkimin e të gjithë njerëzve progresivë të botes në luften për paqë, në luften kundra provokatorëve imperjalista të luftes. Çonje zanin t'uej, ju gratë e Jugosllavis, ju antifashistet, së bashku me gratë e mbarë botes kundra këtyne nxitësave t'urrejtun të luftes, që nuk e kanë provue mjerimin dhe vuejtjen, që nuk kanë kalue nëpër fushat e përgjakuna në të cilat kanë vdekë bijt dhe bijat e popujve t'onë.

Kongresi i juej le të jetë nji nxitje për suksese edhe ma të mdhaja në punen t'uej krijuese për të miren e kolektivitetit t'onë!"

KONKLUZAT E PLENUMIT TE K. KRAHINUER TE FRONTIT POPULLUER

Plenumi i Frontit Populluer te Kosoves e Metohis, mbasi ndigjoi referatin e shokut Gjoko Paikoviq mbi punen e Frontit, referatet e tjere si edhe diskutimin ne lidhje me ta, nxori keto

Konkluza

I

Me punen e tyne te deritashme, organizatat e Frontit Populluer te Krahines s'one tue perfshi pjesen ma te madhe te popullit, jane forcue dhe nepermjet te punes, e kane zhvillue edhe ma fort vllaznimin e bashkimin, tue u-ba keshtu shtyllat e zhvillimit t'one shoqnuer.

Ne punen e matutjeshme politike, para organizatavet te Frontit Populluer shtrohen keto detyra:

1. Fronti populluer, si organizate e pergjithshme politike popullore e qendrueshme dhe fuqi kryesore ne zhvillimin dhe perforcimin e matutjeshem te pushtetit t'one populluer, demokracis s'one popullore, duhet te jete shtylla kryesore e ndertimit ekonomik te Vendit t'one. Organizatat frontiste duhet t'a spjegojne, perpunojne dhe popullarizojne gjithnji Planin Pesvjecar, kryemja e te cilit do t'i sjelle popullit t'one jeten ma te mire e ma te lumtun.

2. Duhet t'informohen si duhet dhe me kohe turmat ma e gjana popullore mbi ngjarjet e mbrendeshme dhe te jashtme politike.

3. Nji kujdes te veçante duhet me ia kushtue punes per popullarizimin e Bashkimit Sovjetik, si fuqi pararoje e kampit demokratik e anti-imperjalist ne luften per paqen e shendoshe dhe demokracin ne bote.

4. Duhet te popullarizohet politika paqedashese qe ndjeke Qeverija e jone, tue nenshkrue pakte miqesije dhe ndihme reciproke me te gjitha vendet e demokracis se re. Me popullarizue politiken paqedashese te te gjitha Vendeve demokratike si dhe te gjitha fuqive perparimtare te botes, ne krye me Bashkimin Sovjetik — garanci e liris dhe perparimit te popujvet t'one.

5. Duhet te demaskohet sistematikisht e dite per dite politika skllaveruese e imperjalistave, me Shtetet e Bashkueme t'Amerikes ne krye. Te luftohen rrepte dhe te demaskohen politikisht reakcjonaret e mbrendshem, si agjenture e imme punen e tyne e pengojne perjalistavet te huej, anmiq qe zhvillimin e Vendit dhe popujve t'one.

6. Duhet te vazhdohet gjithnji per perforcimin dhe aftesimin sa ma te madh te keshillavet t'ona popullore.

II

Për t'a krye ma mire e ma me sukses Planin pesvjecar, Organizatat e Frontit Populluer duhet:

1. Kudo neper sipermarrjet e Krahines s'one t'organizojne garat ne luften per plotesimin e detyrevet te planifikueme ne prodhim.

2. Organizatat e Frontit Populluer te perpiqen per angazhimin sa ma masiv te frontistavet ne punimet vullnetare.

3. Me pjesmarrjen e gjane te te gjithe frontistavet te perpilohen planet pesvjeçave t'organizatavet te Frontit populluer dhe te bahet çdo perpjekje per plotsimin e tyne. Plani i punes per vitin 1948 neper organizatat te shkoqitet nder tre muejsha, ne muej dhe ne kohe ma te shkurtna.

4. Organizatat frontiste t'angazhohen sidoemos per nji ndihme sa ma te madhe ne plotesimin e planit investicional te sivjeteshem.

5. Qe te kryhen sa ma me sukses detyret, t'i kushtohet kujdes i duhun çfrytezimit te drejte te te gjitha burimevet lokale te landeve te para, furnizimit te sipermarrjevet t'ona me materjal dhe lande te para.

6. T'i kushtohet nji kujdes i veçante edhe naltesimit t'ekonomis lokale.

7. Nji kujdes i posaçem t'i kushtohet ngritjes se shtepijavet te djeguna dhe te shkatrrueme ne kohen e okupates e keshtu t'arrihet qe gjate vitit 1948 kjo çashtje te zgjidhet kryekput.

8. Sivjet ngritja e shtepijavet kooperative asht nji nga detyret kryesore te Frontit Populluer. Ne lidhje me kete, organizatat e Frontit duhet tua hyne me njihere pregatitjevet t'Organizimit te njisivet te punes, punes se pregatitjes se landes se ndertimit, sigurimit te fuqis puntore teknike si dhe organizimit te Drejtorinave qe do t'a drejtojne punen e ndertimit te ketyne shtepijavet.

Me organizimin e fondit financjar duhet me sigurue mjetet financiare per sigurimin e ketyne punimevet.

9. Organizatat e Frontit duhet t'u japin ndihmen e plote organevet te pushtetit populluer ne permbushjen e detyreve ekonomike si ç'jane: mbjellja, blemja e tepricave te prodhimevet bujqesore, pagimi i tatimit etj.

10. Tue marre parasyshe se bujqesija asht nji nga deget ma te randesishmet t' ekonomis se Vendit t'one, para se ciles plani pesvjeçar shtron detyre shum te mdhaja, organizatat e Frontit duhet te perpiqen me sa fuqi kane qe t'u spjegojne prodhuesave t'one bujqesor se sa randesi ka zbatimi i te gjitha masavet agraro—teknike ne punimin e tokes: thyemja e tokes lavrim i thelle i vjeshtes, pluhnimi dhe zgjedhja e fares, perdorimi i veglave te reja bujqesore etj. Per kete, duhet t'organizohen ligjerata te ndryshme kulturale dhe teknike, seminare etj. Per kete qellim duhet t'angazhohen teknikët bujqesore.

III

...Tue marre parasyshe mbrapambetjen e madhe kulturale te popullsis se Krahines s'one te trashiguem nga sundimi i huej dhe kundra-popullor, dhe puna kulturalo arsimore ne popull asht nji nga detyrat themelore te Frontit Populluer. Prandaj duhet

1. Akcjonit per alfabetizmin e popullit me i dhane hov edhe ma te madh, me e forcue organizimin, kontrollin, evidencen dhe ndihmen e vazhdueshme per kurset analfabetike. Ketu duhet te çfrytzohen te gjitha fuqinat ne dispozicjon, te gjithe frontistat alfabete, tue mos u-kufizue ne nji numer te vogel mesuesish. Me vazhdue anketen per konstatimin e numrit t'analfabetevet, qe te kemi shenime te sakta.

2. Bibliotekat dhe sallat e leximit qe bemi, me i rregullue ne menyre qe t'i pergjigjen qellimit te caktuem; te furnizohen me libra, revista e gazeta, tue zgjedhe ketu materjalin qe u pergjigjet lexuesavet te ketij ose atij vendi. Duhet me u-perpjeke gjithashtu per hapjen e sallave te leximit nder te gjitha katundet.

3. Me e permiresue dhe zgjanue punen nder universitetet popullore qe kemi, kudo qe per tete [illegible] me desina. Me mbajte ligjerata popullore politike e ekonomike; ketu, me angazhue njerez t'afte dhe teknike n'ekonomi.

4. Me organizue shiqimin kolektiv te çfaqjeve kinematografike dhe teatrale, sidomos nder katunde.

5. Me organizue grupe diletante, kore nder keshilla te vendeve dhe katunde.

6. Me i kushtue kujdes te veçant cashtjes se ndjekjes se shkollave nga femijt e rregjistruem. Mos me lejue qe te krijohen analfabete te rij. Me ruejte me kujdes ndertesat, mjetet mesimore dhe orendit shkollore.

IV

Detyre te mdhaja shtrohen para agitacjonit e propagandes s'one.

1. Me perpilue planet e punes agitacjono propagandistike. Me mbajte ligjerata sa ma masive per ngritjen politike dhe kulturale. Nepermjet t'informimit te drejte te masave mbi ngjarjet, me i s'partallue botekuptimet e damshme dhe paragjykimet e ndryshme.

2. Me organizue aktive te perhershme agitatoresh prane keshillavet te Frontit Populluer të rrethit, qytetit e, ne lidhje me akcjone ma të randësisme, edhe pranë keshillavet të frontit të vendit e të rejonit.

3. Me i sigurue sa ma shum radjo-aparate dhe me i dergue ne katund, si e si populli t'informohet sa ma shpejt dhe ma mirë.

4. Me organizue ruejtjen per shperndamjen e shtypit dhe ate të korrespondences për gazetat t'ona të Frontitt. Me e shtue numrin e pajtimtarëvet.

IV

Për t'a permirsue dhe ruejtë sa ma mirë e ma shpejtë shendetin e popullit, organizatat e Frontit duhet të marrin pjesë gjithnji ndër të gjitha akcjonet që ndermerr pushteti populluer, si: pluhnimin, luftë për zhdukjen e morravet, kundra sëmundjeve ngjitëse, tërbim, mbatje pastertije, ndërtim i nevojtoreve higjenike, thamje kënetash etj.

Duhet me pasë evidencen e nevojtarëve, me shique se kujt i epet ndihma, a ndahet si duhet, a u epet atyne qe meritojnë. Sidoemos duhet me pasë kujdes për fëmijt e pasiguruem. Keta duhet me i mbajtë ose me i dërgue në shtepijat e fëmijvet, shtepijat e nxanësvet (shegertavet) në zanatë etj.

V

Për t'arrijtë që Fronti i jonë Populluer, i cili përfshinë turmat e gjana popullore, të mundet me i aktivizue në mënyrën ma të gjanë antarët e vet në kryemjen sa ma të suksesëshme të detyrevet që shtron para nesh Plani pesvjeçar, ay duhet të përforcohet dhe të rritet organizativisht.

Për ktë duhet:

1. Me i kushtue kujdes të veçantë ngritjes s'organizatavet themelore — atyne vendeve nder rrethe, të rejonevet nder qytete etj.

2. Pranë të gjitha organizatavet të Frontit populluer duhet të formohen si duhet dhe t'aktivizohen dhe aktivet.

(Vazhdon ne faqen e gjashtë)

NGA FUSHATA PARA—ELEKTORALE E FRONTIT POPULLUER

Nëpër të gjitha visat e Krahinës s'onë, populli t'onë pregaditet me i pritë si duhet votimet per keshillat e Frontit Populluer. Nder konferenca, frontistat shqyrtojne punen e deritashme t' organizatavet te Frontit populluer, gabimet dhe te metat e ndryshme, qe janë sjellë në punën e këtyne, mungesë ma te mirë per likuidimin e ketyne te metave dhe gabimevet, si e si Fronti i jone populluer te mundet me dhanë kontributin e duhun në ndertimin e gjithanshem të Krahinës dhe Vendit t'onë.

Nder mbledhje frontistat diskutojne në lidhje me planin pesvjeçar të Frontit, forcimin organizativ të këtij, spastrimin e këtij nga të gjitha elementat e fshehtë anmiqë, qe jane strukë në radhët e organizatës s'one te pergjithshme popullore, me qellim që t'i sabotojnë ma mirë veprën madhështore të popujvet t'onë për ndertimin e socjalizmit.

Ne konferencen e vet para-elektorale frontistat e Keshillit të Frontit te vendit Livadice, (Podujeve), konstatuen se, në bazë të punes së deritashme, organizata e tyne e Frontit asht ma e dobta në rrethin e Llapit: as nji i ri i këtij katundi nuk ka marrë pjesë në ndertimin e hekurudhes Brçko—Banoviç e Shamac—Sarajevo, as ne ndonji akcjon tjeter të Rinis. Rruga e katundit nuk asht ndreqë. Frontistat kanë ardhë shum parregullë apo me nji pakice fare të vogel në konferencë. Nuk i kanë permirësue kushtet shëndetsore te katundit. Tue i shqyrtue shkaqet e këtyne të metave, konstatojnë se ato kanë rrjedhë nga puna e pakët politike n'organizaten e tyne themelore. Aty jeta politike po thue se nuk asht ndie aspak, çka u ka dhanë mundesi elementave anmiqe me u përvjedhë n'organizatën e Frontit populluer e me sabotue punen për naltësimin politik dhe ekonomik të katundit. Ne konferencen para-elektorale, populli i nxurri në shesh, i demaskoi këta anmiq dhe i përzuni nga mesi i vet.

Frontistat, mandej, kaluen në shqyrtimin e projekt-planit pesvjeçar te zhvillimit të katundit te tyne dhe kerkuen zgjanimin e këtij plani. Plani pesvjeçar i Livadices parashef ndryshime mjaft te mdhaja në jeten e këtij katundi për këte vit. Livadica bashke me dy katunde tjerë do te ndertojne nji godinë te madhe për shkollën fillore, për mos me qenë nevoja që fëmijt e shkolles te hecin kambë deri në Podujeve. Katundaret janë tue çele nji rrugë lokale 2 km. të gjatë; ata do t'a ndreqin edhe rrugën nëpër katund. Te rijt kanë vendosë me plotesue ate çka kane lanë mangu gjate viteve të kaluem: i tane aktivi, prej 21 antareve, do të shkoje në brigaden, e cila ka me e ndertue shtepin kooperativiste në Podujeve. Frontistat do t'a ndihmojnë ket akcjon në te holla dhe tue e bajtë materjalin e nevojshem. Femnat do t'i ndihmojne me gjanu ushqimore etj. puntoret, qe do t'a ndertojne shtepin e kooperatives. Ket vit frontistat do ti kushtojne nji kujdes ma te madh çeshtjes se permiresimit të kushteve hygjenike te katundit.

Ne Planin pesvjeçar parashifet, gjithashtu, pyllëzimi i nji mereje të çveshun, e cila perpara ishte si vend kullotjeje per bagtit e katundareve ma te pasun. Asht per t'u vue në dukje ketu sidomos fakti qe edhe pionerët kanë marrë detyrimin e vet ne lidhje me kete akcjon: ata do t'a mbledhin farën e bagremave.

Ne vitin 1949 parashifet me plan ndertimi i shtepis se madhe kooperativiste, e cila do t'i ploteroje nevojët e tri katundeve; rimeremetimi i te gjitha rrugeve te katundit dhe hapja e rrugës prej Livadices ne Shtedim, me nji gjatesi 2 km. Ne vitin 1950 frontistat do t'a ndertojnë godinen e keshillit populluer te vendit dhe do t'a perfundojne shtepin kooperativiste, ne qoftë se mbetet pa u-krye krejt ne vitin 1949. Ne vitin 1951 do te ngrihen nderteset ndihmese te kooperatives: depoja per vegla, mashinat; magazina, puntorija mekanike, furra e kooperatives etj. Analfabetizmi do te likuidohet ne kete katund mbrenda vitit 1949. Ket vit frontistat ma te vjeter, me ndihmen e rinis, do t'a pregatisin vendin per qitje në shenj e, ne vitin 1950, fushen e fiskulturës.

Katundi mori persiper detyrimin qe ne vitin 1951 te nxjerre nga toka me cilsi te mesme keto prodhime per çdo hektar: 1650 kgr. theken, 1500 Kgr. grun, 1400 Kgr. misër e 1200 Kgr. lule dielli; do t'a shtoje edhe ma teper prodhimin e konopit dhe barishteve, do t'a trefishoje numrin e bagtive dhe, deri me vitin 1951 do t'a perfishoje numrin e shpezve.

Qysh ne ket vit çdo familje do te pajtohet ne shtypin e perditshem dhe perjodik.

Prej detyrimeve kolektive u kalue ne ato individuale, çka tregoi se popullsija e këtij katundi don te luftoje per realizimin e planit pesvjeçar, sepse asht e vetedijshme se keshtu ndertohet jeten ma te mire per vehte e per femijt e vet.

Keto konferenca jane mbajte edhe ne keshillin e vendit Gllavnik te Podujeves, ne Sibovcin e Poshtem e t'Eperm. Kudo populli shprehu vendosjen e tij te ngulte me i pastrue nga radhet e veta te gjitha therrat qe perpiqen me na pengue rrugen e ndertimit te shoqnis se re socjaliste n' atdheun t'one. Populli po u a nxjerre bojen si duhet elementave anmiqe tinzake, qe, tue u mshefe mbrapa libreze s'antaresis se Frontit, jane mundue me pengue marshimin t'one fitimtar drejte ardhmenis s' one ma te lumtun. Sa interesant ka qene ne konferencen e Gllavnikut, momenti kur katundaret ia thojshin ne sy Ali Rrahmanit se ka thanë: **„ma mire me vdeke se sa me jetue ne kete Jugosllavi", ose „trupat turke kane ardhe ne Greqi e veç kur te na vijne kendej, veç kur t'i shofim„, ose kur i thojshin Zeqir Lales se asht mundue me u a mbushe mendjen te tjerve, mbas fjalve t'Ibrahim Lutfiut — agjentit te gestapos giermane e tash te zotnive te rij imperjalista se s'ka me ndreqe puna, ose kur e demaskojshin Ram Murtezin, i cili, sikurse Ali Rrahmani, ka thane se trupat turke kane me ardhe shpejte kendej e do t'a bajme Turqin e madhe: ose kur ia qitshin lakmat ne shesh Sherif Rrahmanit, qe ka propagandue per mos-shitjen e teprices te drithit dhe per mos-zbulimin e femnes muslimane shqiptare.**

Fakti që Sherif Rrahmani, Zeqir Lala etj. me gjithse këshilltarë të Frontit, kane veprue këtësoji provon se elementat anmiqë nuk lanë mënyrë pa perdorë për t'a minue punen e popullit t'onë puntor. Nga ana tjeter, demaskimi i duhun i ketyne elementave nga ana e masave t'ona popullore, provon faktin qe ndergjegja politike e popullit t'onë po ngrihet dita dites ma teper, faktin se ne popujt t'ona po forcohet sy-çeltija politike ne luften e pa-pajtueshme kundra te gjithë elementave anmiqë, të hapet ose te maskuem, që mundohen, për interesat e tyne të ngushta dhe per hesap t'imperijalizmit, që po ban dita dites grushte nga fuqit shum ma te forta demokratike te botes, me pengue ndertimin e ardhmenis ma të lumtun të popujve t'onë. Nëpër të gjitha konferencat paraelektorale te Frontit çfaqet pjekmenija politike e turmave t'ona, te cilat kanë vendosë me likuidue çdo pengesë qe mund t'u dalë përpara në rrugen e jetes së re.

Ndertimi i shtepijave te kooperativavet-nji nga detyret ma me randesi per perparimin e bujqesis s'one

Katundarija e jone po vjen tue e kuptue dita dites ma mire se kooperativizmi asht forma ma e mire e organizimit te bujqesis, se kooperativizmi i siguron katundaris punonjese nji jete ma te kulturueme e ma te begatshme.

Mbassi ne katunde kooperativizmi po shkon gjithnji tue u-zhvillue dhe zgjanue si duhet te perforcohet si ne pikpamje organizative ashtu edhe te cilesis. E kjo kerkon ndër sigurimin e bazes materjale — ndertimin e shtepijavet te kooperativavet.

Te gjitha organizatat e Frontit duhet te bajne çmos per te ndihmue ne suksesin e ketij akcjoni — akcjonit te ndertimit te shtepijavet te kooperativavet nder katundet ku jane zhvillue kooperativat e ku kooperativistat deshirojne t'a ngrejne shtepin e vet. Çashtja e ndertimit te shtepijavet te kooperativavet asht organikisht e lidhun me te gjitha problemet qe duhet te zgjidhen ne rrugen drejte organizimit te bujqesis s'one. Ket reorganizim duhet dhe do t'a baje vet katundarija, sepse, ne radhe te pare, ay asht n'interesin jetesuer direkt te saje. Me perpjekjet e saja te vetedijshme, nen kushtet e sotshme te pushtetit populluer, katundarija e jone nepermjet te kooperativizmit do t'a perforcoje ekonomin e vet, bujqesin, pergjithsisht, don me thane do t'a ndertoje jeten ma te mire.

Vet kooperativistat, nder mbledhjet e tyne, duhet te vendosin ne lidhje me ngritjen e shtepis se vet, do te caktojne madhesin e saje e vendin ku do te ndertohet.

Vertete ndertimi i shtepijavet te kooperativavet asht, pike se pari, pune e vet antarevet te ketyne, por ajo nuk mund t'arrihet pa ndihmen e organizueme te Frontit Populluer. Organizatat e Frontit, qe i jane pergjegje inisiatives se vet kooperativistavet, jane dhe duhet te jene pioniere organizative dhe politke te ketij akcjoni dhe nji nder organizueset kryesore te turmavet. Aktivistat e Frontit Populluer duhet t'ua spjegojne kooperativistave randesin e madhe t'organizimit kooperativ dhe randesin e ngritjes se shtepijavet te kooperativave. Keshtu katundarija e jone do t'a kuptojne se shtepija e kooperatives asht shkolla ku kooperativistat mesojne me i mbareshtrue punet e kooperative: me zgjidhe bashkarisht lloj-lloj problemesh e me marre pjese direkte ne perpilimin e planit te kooperatives. Nepermjet te kooperatives katundari do te mesohet me mbareshtrue punet e perbashketa te katundit te tij. Nder mbledhje, ne diskutime, ne sallen e leximit te shtepis se kooperatives, me ane te jetesis se bibjotekes se kooperatives, kooperativistat do te skjarohen rreth shum problemevet ekonomike, politike e kulturale. Tue punue kesisoji, tue i perfshi te gjitha anet e jetes ekonomike dhe kulturale te katundarevet, kooperativa do te ndihmoje permirsimin e jetes se katundaris, ngritjen e nivelit te saje kultural e politik, ajo do te mesohet me e mbareshtrue ekonomin ma mire e me çue nji jete ma te kulturueme.

Ngritja e shtepis se kooperatives do t'a terhjeke drejte per se drejti ne punen e perbashket e t'organizueme si dine ne planin shtetnuer; katundarija e jone keshtu do te bindet ma shpejte per lidhjen organike ne mes t'interesave te saja dhe interesave te pergjithshme te katundit si dhe interesit te pergjithshem te katundit, si dhe interesit te pergjithshem te mbare Vendit.

Mbasi Shtepija Kooperative do te jete qendra ekonomike dhe kulturale e katundit, ne ndertimin e saje do te marre pjese i tane katundi. Fronti Populluer organizon punet vullnetare, ku do marrin pjese njisina pune te qendrueshme frontiste. Si kudo, edhe ne ket akcjon, Rinija e jone Popullore asht krahu i fort kooperativave dhe i Frontit Populluer.

Siç ka thane shoku Kardelj, „organizatat e rinis s'one popullore e kane per detyre me randesi dhe te nguteshme që t'a perciellin frymen e vet nga hekurudha e Rinis, ne rinin t'one ne bujqesi".

Ne hekurudhen e Rinis, ne hekurudhen Golesh—Bellaçevac, Obiliç—Kosovo, Nerodimlje—Jezerce etj. rinija e jone ka fitue mjaft eksperijence ne pikpamje pune dhe organizative, prandaj ajo ka me dhane nji ndihme te çmueshme ne ndertimin e shtepijave kooperative. Hovi i rinis s'one do te percillet ne te gjithe antaret e Frontit Populluer ne katund. Qysh gjate ndertimit te shtepijave kooperative, nepermjet te punes se perbashket çfaqjevet dhe formavet te tjera, katundi do te bashkohet edhe ma teper rreth kooperatives. Nepermjet te punes se perbashket, tue kapercye se bashku veshtirsinat e ndryshme, mbare katundi do t'a kuptoje randesin e shtepijave kooperative, e do t'i dije keto qysh ne fillim.

Tue marre pjese e tue u-perpjeke sa ma teper ne lidhje me ndertimin e shtepijavet te kooperativavet, frontistat do t'i bashkojne edhe ma teper turmat punonjese te katundit rreth Frontit dhe do t'a shtojne autoritetin dhe fuqin politike te Frontit Populluer.

Ne kete akcjon do te perforcohet aleanca puntoro—katundare. Organizatat sindikale do t'a ndihmojne kete tue organizue jashta orarit punen vullnetare per t'ua sigurue shtepijave te kooperativave orendit e ndryshme qe u nevojiten.

Ne ket akcjon do te forcohet vllaznimi e bashkimi i popujve t'one.

Pregaditjet per mbjelljet prendverore

Stacjonet e maqinave e te traktorave duhet të punojnë edhe ma me gjallni per kryemjen e planit te pregaditjeve

Në të gjitha stacionet e Krahinës s'onë asht fillue puna për reparimin e maqinave dhe traktorve: Për të muejt me i krye me kohë të gjitha meremetimet, stacjonet i kanë përpilue planet operative përkatëse dhe kanë ba nji kontroll të përgjithëshëm për çdo maqinë. Me ketë rast asht konstatue se nji numër i madh maqinash dhe traktorash asht jasht përdorimit. Tue e marrë parasyshë se katundaris s'onë i asht shtue koshjenca për përdorimin e maqinave në bujqësi, mbi prioritetin e tyne ne punë etj. dhe tue qenë se sivjet ka me u-mbjellë nji sipëpfaqe edhe ma e madhe se sa në vjetin e kaluem, para stacjoneve, shtrohet për detyrë mâ urgjente meremetimi i të gjitha maqinave, në mënyrë që këto të jenë të gatshme me fillue nga puna e mbjelljeve sa ma parë.

Simbas planit të parapamë, të gjitha pregatitjet duhet të përfundohen deri me 1 mars. Kolektivi punonjës i stacjonit të Prishtinës ka marrë përsipër që deri me 25 fruer të përfundojë punën e pregatitjeve, edhe me të vertetë do t'a përfundojë në qoftë se vazhdon me punue po me atë hov që ka punue në fillim të kallnorit dhe në qoftë se i mbrrijnë disa vegla te nevojshme për meremetimin. Në të gjitha stacjonet e Krahinës puna asht tue u-zhvillue me norma dhe bahen gara për plotësimin e planit. Mirëpo, me gjithë punen e deritashme, nuk janë mbrrijtë përfundime të kënaqëshme. Stacjoni i Prishtinës i ka krye meremetimet për 50%, i Pejes për 42%, e ai i Ferizajt vetem për 32%.

Përveç meremetimeve, pregatitjes së kuadrave etj. stacjonet duhet të kujdesohen për ndamjen e drejtë të kuadrave profesjonale, pë ndamjen e brigadave në terren, me i sigurue me kohë karburantat, për ushqimin dhe vendosjen e traktoristave etj. Përveç kësaj duhet të vendosin nji bashkëpunim edhe ma të ngushtë me organet e pushtetit populluer e organizatat popullore në terren.

Stacjonet e maqinave, duhet t'i lidhin me kohë edhe kontratat me bujqët si dhe me kooperativat bujqësore të punes.

Në qoftë se stacjonet i bajne me kohë të gjitha këto pregatitje, mund të pritet se këto do të jenë në gjendje me e plotsue detyren e tyne të prodhimit dhe me i krye me sukses mbjelljet prandverore.

Femnat shqiptare te Bellacerkes e hoqen definitivisht çarshafin

Si rrjedhim i konferences Krahinore te Komitetit te Shqiptarve te Kosmetit, ku nder te tjera iu kushtue randesi e veçant emancipimit te grues shqiptare, shofim qe aty ketu po praktikohen detyret e marruna n'ate rast prej komiteteve shqiptare te rretheve.

Mesuesi i Bellacerkes H. Siqeca, na shkruem se para disa ditesh prej 5 katundeve te këshillit vendit Bellacerke (Rreth'i Podrimes), ne nji miting t'organizuem prej vete antarve e antareve te Komitetit Shqiptar, qenkan mbledhe rreth 300 gra e vajza te zbulueme ne ket katund si dhe mjaft burra dhe djelm. Femnat shprehen me gojen e tyne se nuk do t'a veshin ma çarshafin e zi - shejin e robnis trashigue prej Osmanlijve t'Anadollit. Ato premtuen para te gjithve se kjo gja mori forme te preme nji here e pergjithmone. N'anen tjeter ato i ftuen te gjitha shoqet tjera te rrethit te Podrimes per te hjeke çarshafin, i cili nuk po i len ato te marrin fryme lirisht e te punojne lirisht.

Ne meting u-mbajten disa fjalime ne lidhje me ket dite gezimi per popullin e Bellacerkes. Njeni ne fjalimin e tij theksoi se me keso inisjativash do te permbushin edhe femnat shqiptare detyret qe ua parashtron Plani pesvjeçar, me kryemjen e te cilave do te realizojne nji jete ma te mire e ma te lumtun per popullin shqiptar.

Ne fund te fjalimeve, me deshiren e te gjithve, iu drejtue nji telegram Marshalit Tito, ku nder te tjera thuhet: "dhe ne grate e Bellacerkes do te kontribuojme sa ma shum si te gjitha shoqet perparimtare te popujve vllazen t'Atdheut t'one, per realizimin e Planit pesvjeçar.

Shembullin e mire te katundareve te Bellacerkes, duhet t'a vazhdojne te gjitha vendet e Krahines s'one. Vetem keshtu femnat shqiptare mund te realizojne Planin pesvjeçar, drejt jetes se lumtun te socializmit.

Kush lufton spekulimin, ndihmon permirsimin e jetes se popullit t'onë puntuer

Popujt t'one, i gjithe populli i jone puntor po ban perpjekje te mdhaja per permbushjen e detyreve te Planit pesvjeçar, per ndertimin e socializmit. Por disa njerez e pengojne zhvillimin t'one ekonomik, e pengojne ndertimin t'one te ma tutjeshem dhe perpiqen me e çrregullue jeten t'one ekonomike, si e si te pasunohen ma lehte, ne dam te shtetit dhe te popullit puntor, ne dam te zhvillimit t'one te matutjeshem.

Ne fjalimin e mbajtun me rastin e vitit te ri, shoku TITO, tue fole per keta fare njerzish, ka thane:

"Ka asi njerzish te cilet nuk duen kursesi te punojne per kolektivitetin, por shiqojne me e sigurue jetesen me ane spekulimesh te ndryshme ase te ndonji menyre tjeter jo-produktive, d. m. th. ne dam te komunitetit. Kesisoji keta fare njerzish veprojne si anmiqe te Jugosllavis se re, nuk duen qe na te triumfojme ne ndertimin e vendit t'one, ardhmenis s'one ma te mire".

Spekulimi asht nji nga format e veprimtaris qe zhvillojne elementat anmiqe ne fushen ekonomike e qe kane per qellim me i dobesue fuqit konstruktive te ndertimit socialist. Ata jane demaskue dhe thye ne fushen politike, por veprojne gjithnji ne terrenin ekonomik, i çfrytzojne mjeshtrisht te metat organizative t'aparatit t'one shtetnor dhe kooperativ te blemjes dhe shperndamjes dhe veshtirsinat e perkoheshme ne lidhje me furnizimin, per t'i arrijte qellimet e veta spekulative, per t'a ule standardin jetesuer te njerzve t'one puntore.

Spekulantat s'lane mundesi pa çfrytzue per t'a diskreditue sektorin t'one shtetnuer dhe kooperativ te tregtis. Zaten as qe mund te pritet prej tyne ndonji qendrim tjeter. Ata jane mbeturinat e shperta te klasavet çfryteztuese, anmiqe te natyrshem te ndertimit t'one socialist.

Per sa u perket spekulantave shqiptare asht mire t'a theksojme se nji nga arsyenat per te cilat ata e pengojne çashtjen e zhvillimit te femnes s'one asht edhe kjo: atyne u nevojitet çarshafi edhe per me mujte me e fshefe spekulimin ho t'ahanden. Gjithashtu duhet theksue se disa spekulanta, per t'u maskue ma mire, nuk mbajne duqan te vetin, vishen keq si mos me pase gia mbas shpirti, ankohen se nuk po mujne me mbete gjall kurrqysh, kurse nga ana tjeter kane krijue ne vende te ndryshme rrjetin e agjensive te veta qe punojne nen dhe. Plasin tue i qa hallet, sa, me ba mos me i njofte e mos me ua dijte punen, njeriut kish me i ardhe keq per ta. E pra spekulimet e tyne vazhdojne e me anen e tyne me pak ose aspak mund e pa i dhane kolektivitetit asgja, por tue e damtue, ata sigurojne shpesh here mbrenda muejit ma teper se sa ç'fiton njeriu i ndershem puntor, me pune e perpjekje per mbare shoqnin t'one, mbrenda disa muejvet.

Disa spekulantave, me ba me u a pa duqanin e kane aq te vogel dhe me aq pak malle, sa me, i shkue njeriut mendja se asht tregtar i keputun. Por dyqanin kryesuer e kane podrumin e fshehte. Dyqani i vogel asht vetem nji maske dhe nji menyre per t'u shpetue lehte detyrimevet te shtetit. Mallin e podrumevet nen dhe e shesin nen dore, pa leje dhe pa i pagutun shtetit kurrfar taksash.

Nji tip i veçante spekulanti asht spekulanti i katundit, qe nuk i shet prodhimet e veta, por blene prej bashk-katundarvet te tij gjanat ushqimore dhe vjen e shet ne qytetet. Tue u-lule keshtu si ndermjetes ne mes te prodhuesit dhe bleresit, ai shkakton ngritjen e çmimeve. Per me fitue edhe ma teper, shpesh here edhe i prishe gjanat ushqimore, bje fiala tue e perzie tlynin me vjame e me patate etj.

Luftes kundra spekulimit — ne çfaredo forme qe te paraqitet — duhet me i kushtue nji kujdes te madh. Çdo frontist n'organet e pushtetit populluer e n'aparatin tregtar shtetnuer dhe kooperativ duhet te jete gjithmone syçelte dhe t'a luftoje ne çdo hap spekulimin, ket forme veprimtarije t'anmikut te drejtueme kundra popujve t'one, t'i zhdukin nga tregu ndermjetesat e ndryshem spekulanta. Frontistat nuk duhet te harrojne se ndodhe qe keta plaçkitesa, tue mos mujte me luftue balle per balle ne fushen ekonomike, fusin agjentat e tyne n'aparatin t'one te tregtis, per te sabotue shperndamjen me kohe te mallnave etj. — dhe ne menyre te ndryshme sigurojne mundesin per vepren e tyne grabitçare. Ndodhe gjithashtu qe te shkojne me ble diçka n'emen te sipermarrjeve t'ona shtetnore e kooperative e n'at mes, me paret e popullit nxjerrin fitime per vehte.

Te gjitha organizatat e Frontit e kane per detyre me kontribue ne luften kundra spekulimit, tue i dhane nji ndihme te gjitha organevet t'ona te pushtetit, tue lajmerue per çdo cfaqje spekulimi dhe çdo element spekulant. Ato duhet te zhvillojne kudo, sidomos ne katund, punen agitacjono—politike me anen e se cilës t'u spjegohet masavet rroli dam prues i spekulantave dhe nevoja e luftes kundra tyne.

Por ketu duhet te skjarohet kjo: si thote fjala e urte popullore, duhet me ia ngjite gjarpnit ne krye e jo ne bisht.

Ne vend se me ndejte tue i kontrolue straicat dhe shportat diteve te pazarit, duhet me shique se kush shkon ne katund, shka blene me shumice, me çfare çmimesh, per kend blene e ku e çon per me shite.

Nuk mund te kemi shberabim te drejte ne ses te artibive te katundit dhe atyne te qytetit, deri sa asht ne mes spekulanti, si ndermjetes.

Siç ka thane shoku Boris Kidriq, „Ai qe perpiqet me fitue ne kurriz te tjerevet e ne dam te popullit puntor te katundit a te qytetit, asht spekulant, e na mund t'ia ndalojme kete. Per spekuluesa nuk ka ma vend ne sistemin t'one shtetnuer dhe ekonomik. Ata jo vetem e keqesojne tashti gjendjen e njeriut t'one puntor, por perbajne nji pengese shum serjoze per zhvillimin e matutjeshem ne marredhanjet t'ona ekonomike".

Sipermarrjet tregtare shtetnore e kooperative e luftojne ma se miri spekulimin, po qe se bajne çmos qe t'a organizojne rrjeten e tyne te blemjes dhe keshtu t'i zhdukin nga tregu ndermjetesat e ndryshem spekulanta te cilet u a ulin atyne prestigjin ne sy te popullit, plaçkisin shtetin dhe turmat punonjese dhe damtojne ekonomin popullore.

Nuk asht aq sepse mungojne artikujt e ndryshem qe sipermarrjet t'ona tregtare s'e kryejne ende si duhet detyren e tyne, por ma teper sepse nuk e organizojne furnizimin mire, me plan, sepse u mungon organizimi i duhun n'aparatin dhe ne planifikimin e shperndamjes. Sipermarrjeve t'ona u mungon shkathtesija dhe shpejtesija ne pune. Zhdukja e ketyne te metave asht kusht i domosdoshem fitoreje ne luften kundra spekulimit.

Ne fjalimin e mbajtun me rastin e viitit te ri, shoku Tito ka thane:

„Per sa i perket furnizimit duhet me ba nji kthese te ngutshme dhe rranjesore kah ma e mira, sepse keto jane çashtje shum me randesi, per te cilat duhet me dhane llogari, sepse e damtojne shum shtetin — si tanesi".

E pra nji nga pjeset perbase te kesaj kthese ne lamen e furnizimit asht edhe perzanja e ndermjetsavet nga organizmi i jone ekonomik d. m. th. zhdukja e pamëshirshme e spekulimit — ne çdo formë qe te çfaqet.

Akcjoni i pyllzimit prendveruer ka fillue ne disa rrethe te Krahines s'one dhe po zhvillohet me sukses

Në konferencen e referentave të pyjeve, e cila u-mbajt këto ditë në Prishtinë, u-shqyrtue hollësisht çashtja e shoqnive për akcjonet e pyllëzimit prandveruer. Akcjoni ka fillue në disa rrethe. Plani asht zgjanue për shkak se në rrethin e Mitrovicës dhe në disa kooperativa bujqësore kanë mbetë afra 150.000 fidane prej pyllzimit të vjeshtes. Këto fidane u janë shpërnda disa rretheve dhe simbas planit të zgjanuem në Krahinën t'onë, gjatë akcjonit prandveruer të pyllëzimit do të pyllëzohen 15, 000 hektarë shogina.

Akcjoni po zhvillohet me sukses në saje të kohes së mirë. Rreth Shtimljes deri tash janë vu 25.000 fidane bagremash e 12.000 fidane mani të bardhë. Në rrethin e Prishtinës - 37.000 fidane e n'atë të Suharekes 5.000 fidane. Këto ditë ka fillue pyllëzimi edhe në rrethin e Prizrendit. Për pyllëzimin e shoqines së Hoçes, rrethi i Prizrendit, janë dhanë prej fidanishtes 10.000 fidane. Në rrethet tjera ku asht parapa pyllëzimi prandveruer' akcjoni duhet të fillojë së shpejti.

Akcjoni tjeter jo ma pak i randësishem, për të cilin u diskutue në konferencë, asht akcjoni i mbledhjes së farës për pyje. Me plan të Drejtoratit të pyjeve asht parapa të mblidhen 1500-1600 Kgr. farë bagremi dhe nji sasi fare për pyje me blerim të përjetshem. Deri më sot kësaj çashtjeje nuk i asht kushtue kujdes i duhun. Nga referati del se deri më sot janë mbledhë vetem 600 Kgr. farë bagremi. Rrethi i Prishtines deri më sot nuk ka mbledhë asnji Kgr Ky akcjon duhet të marrë fund në mbarim të muajit fruer. Prandaj duhet me i çfrytëzue të gjitha mundësinat. Referentat e pyjeve duhet të lidhen me njiherë me këshillat e Frontit nëpër rrethe. Frontistat e sidomos organizata e pionerve duhet ta mbledhin dhe pastrojnë farën, sepse prej kësaj mvarret prodhimi i materjalit për akcjonet e ardhëshme të pyllëzimit.

D. T.

Mulla Ademi, njeriu i „mrekullinave" dhe viktimat e tij

Te rralle janë ata njerëz, të cilve u ka besue Allahu aq shum autorizime sa Mulla Ademit prej katundit Lubec afër Podujevës. Gzojnë fame te madhe ky dhe hoxha i katundit Sretla, shpirti i past rahmet, i cili, para se te shkonte ne zhenët, ka kumtue se hekurudha Prishtinë — Kurshumli kurrë s'mund të lëshohet në komunikacjon. Mulla Ademi s' merret me këso profetnish sepse s'ia del hesapi - mund te damtojne shum. — Edhe ne se ban keso profetninash, i kumton vetem në rrethin e miqve e dashamirevë te tij, të cilët shpesh here e lane vetem shoqnin e tyne të kafehaneve te fliqta të Prishtines, në të cilat komentohen gjen' e gjate rrenat e Radio Ankaras, tue ia pershtate dëshirës për me u-kthye „e kaluemja" që nuk vjen ma. Mulla Ademi merret kryesisht me zanat shum ma te pershtatshem, per të cilin ka „prirje" dhe prej të cilit ka qar ma të madh.

Shtëpija e tij në Lubec asht ka „ambulance" për sjekrrat me të rejat e tyne, per lehonat, për nanat me korthi për njerezit e marrë, te cilve as kollugjerët virgjen s' kane mujte me u ndihmue, te smundët prej ethave etj. Për çdo smundje Mulla Ademi gjen barin. Ky „vakton diagnozën", i jep barnat" dhe „e ruan të smundin". Kurkush nuk mund te dije se kah i ka mësue keto gjane.

Ne sekretin e shejte të magjive të Mulla Ademit s'asht veshtire me hy. Ja se ç'ka ban: — Nji te smundit prej ethave, Mulla Ademi ia ka lidhe nji pe rreth dorës dhe ia ka dhane nji voe te pjekun me e hanger në esull për tri here ulun mbi nji gur ndeje. I ka dhane edhe nji hajmali (nuske) te cilen duhet me e thartësue n'ujë e mandej me e pi kët lang me të cilin „do te shëndoshet". Ket marifet katundari ua ka tregue disa kojshive te tij. Disa besuen në plotfuqin e Mulla Ademit të cilon „ia ka fole Allahu", deri sa nji katundar i urtë u tregoi konkretisht se ku qendron lepri.— Muer nji kaherr voe, e ngjenhi me pe ehe e futi ne hinin e ngrofte. Veja u poq e peni nuk u dogj, sepsë hini e ka pengue depertimin e ajrit e zjarrit. Qe kështu ra poshte autoriteti i Mulla Ademit, por vetem pjeserisht. Ky ka edhe mjete tjera per „mjekim". Qe nji shembull i tmerrshem:

— Nji mysafir i rrettit i Mulla Ademit; tue kalue nepër koridorin e errët e të ngushte të shtëpis se ketij, ndigjon nji bertime të madhe e të dhimbëshme në nji dhomë e hyni mbrenda. Çka me pa! — në sezhaden e shtrueme rrinte nji grue mjaft e moçme e cila mbante ne prehnin e saje nji grue të re. E vjehera e kesaj nuseje rrinte aty prane në nji trekambesh. Nji grue tjeter shqiptare perkundete djalin në nji qoshe t'odes se Mulla Ademit. Ne fillim gadi nuk shifej kurrgja në dhome sepse ishte e errët-dritaret e vogla ishin te mbeshuna me leter të trashe. Në mi dis te dhomes gjindej zangari me prush të fikun. Mbi çadren e shtrueme gjindeshin disa thupra, te trasha e të holla: ne mes te tyne ishte Kurani i çelun.

Mbasi erdhi pak ne vehte Ljubica, gruaja e Ljubinko Stevçiqit, nepunes i këshillit popullues të rrethit të Prishtines, vazhdoi te bertase „nuk di, nuk kam çka me pohue". Balli i sajë ishte plot shkronja arabe, te shkrueme me thengjill-keto i ka kopjue Mulla Ademi prej Kuranit ne ballin e se shkretes Ljubica. Fytyra e saje ishte zi dhe la ne lete. Duhej se grueja ishte tue linde foshnjen. Fjalet e vizituesit: „Vetem vazhdoni punen" e inkurajuen hoxhen, i cili vazhdoi punën e tij kriminale. Duart ia kishin lidhe me konop te trashe. Mulla Ademi ia lidhi edhe të dyja kambët, hypi me kambe në gjujt e saje, ia qei shuplakat e kambëve, rroku me dore të djathtë shtagen e gjate gryetm mbre dhe filloi me sjelle në shuplaka te kambave me aq fuqi kishir.

Ty te ka hy dreqi, je martue me dreqin! Prano, trego emnin e tij, prano! — fliste Mulla Ademi me gjakftohtesin ma te madhe, e shtaga e forte e thanës kërciste vazhdimisht në kambet e gruas se mekun.

Ke shkele dreqin në kryqëzim dhe je martue me te. Tregoje emnin e burrit! — vazhdoi Mulla Ademi.

Mysafiri po kjartusi se ku qëndron puna, ndërpreu hoxhen dhe iu kërcnue se do ta burgosi. Por Mulla Ademi nuk u frigue shum tue dijtë se mund të mshifet mbrapa dispozitave mbi lirin fetare. Filloi me përdorë mjete tjera nga „barnatorja" e tij per të sherue të smunden.

Ne nji copa letër në të cilen, qysh para lufte, ka qenë mbështjellë duhani, Mulla Ademi shkroi disa shkronja arabe me ngjyrë të kuqe. Ngjyrën e nxuer prej nji shisheje të vogel, e mandej e perveliti te vishen e Ljubicës që te gjitha hajmalinat t'i lage ne pak ujë. Ket ujë le ta pije Ljubica për t'u shëndoshe. Uji do te jetë i kuq, por mos kini frige, sepse asht gjaku i dreqit qe e ka kape Ljubicen".— Ne shishe do te kishte pasë ma shum gjak sikur e smunda te kishte pohue dhe sikur të mos me kishte pengue ky mysafir — tha Mulla Ademi. Mysafiri nderhyni dhe tha se ketu nuk qëndron puna ne gjakun e burrit te Lubices-dreqit, por ne ngjyren qe po shkrihet n'uje.

...Me punën e këtillë kriminale, Mulla Ademi, asht pasunue. Prej katundarve të vorfen ka plaçkitë nji kerdi dhenesh. Pula e voe i sjellin me vehte të smundit. Në shej nderimi katundaret i sjellin Mulla Ademit shum dru dhe i japin me qinda e qinda dinarë. Këshilltarët e pushtetit popullues të vendit dhe të Frontit popullor mbajne qendrim indiferent ndaj Mulla Ademit, sepse; thone, ky nuk ban kurrgja kundra ligjit e shtetit. Disa shkojne bile aq larg sa vertetojne se s'ka doktor ma të mirë se Mulla Ademi. Ata nuk shofin se sa gra vuhatohen mbas „diagnozes" dhe „therapie" se Mulla Ademit dhe sa lehona vdesin, mbas vizites se tij. Ljubica Stevçiq, shtazane, do te kishte mbarue sikur Mulla Ademi të kishte vazhdue „me i përzane shejtanat prej saje".

Do t'ishte mirë sikur të gjindeshin njerëz të cilet do t'i perzejshin dreqnit prej Mulla Ademit, qofte edhe tue përdore njanen prej atyne shtagave te thanes që rrinë ne „barnatoren" e tij.

M. Gj.

Fiskulturistat e gjimnazit te Prishtines vizituen aktivin fiskultural te katundit Milloshevo

Para disa ditve 163 fiskulturista e fiskulturiste te gjimnazit të Prishtines vizituen aktivin fiskultural të katundit Milloshevo për t'i tregue praktikisht si zhvillohen orët e edukimit te përgjithëshem fizik si dhe si banen garat per shejin e fiskulturistave. Me vehte muerren edhe shum vegla e rekuizita per t'ua paraqite sa ma mirë fiskulturistavo te katundit se si e me çka duhet me i plotësue format themelore te punes fiskulturore në katund.

Pritja e fiskulturistave nga ana e aktivit fiskultural te katundit Milloshevo nuk asht organizue mirë, me gjithse për ket vizitë asht njoftue këshilli fiskultural i rrethit. Aktivi nuk ka pasë kurfarë dijenije për ket gja, e kështu nji numer fare i vogel antaresh t'aktivit asistoi n'ekzekutimin e ushtrimeve. Me gjith ket fiskulturistat i kryen ushtrimet e orës së edukimit te përgjithëshem fizik, formuen komisjonin për dhanjen e normave dhe kryen disa norma. Nji ekskursion kso soji fiskulturistat e gjimnazit të Prishtines kanë parapa ta bajnë edhe në katundin Fushë-Kosove.

Kah gjysa e muejit fruer te këtij viti fillon kampionati i foot-ballit ndërmjet te gjitha shoqninave fiskulturale te Kosmetit. Për ket kampionat jane njoftue te gjitha shoqninat dhe kudo po bahen pregatitjet.

Në popull dallohet interesim i madh.

Arsim e kulturë

Me interesimin e Pushtetit populluer dhe me inisjativen e popullit, katundi Tugjevc hapi shkollen e vet shqipe

Tue marrë parasyshë nevojen e madhe qe kishte katundi Tugjevc (rreth' i Kamenices) per të pasë shkollën e vet shqipe, Drejtorati i Arsimit caktoi nji mësues, i cili asht paraqitë atje që me 1 Dhetuer të vitit të kaluem. Me këtë rast u-realizue deshira e katundarëve, por ata nuk e ndijshin vedin të qetë derisa nuk e kishin të sigurueme lokalin e shkolles dhe orendit e saja. Tue e pa vullnetin e mirë të katundarëve, instruktori i rrethit të Kamenices Kasem Saka dhe mësuesi Ukë Plakiçi mbajtën me ta nji konferencë të posaçme per këtë qellim.

Konferenca pat nji gjallni të shquerme sepse katundaret menzi pritshin të hapej diskusjoni dhe të paraqitshin mendimet e tyne tue dhane kontributin qe ata deshrojshin.

Shofim per shembull qe këtij akcjoni lokal i prinë kryetari i keshillit të vendit shoku Beqir Sherifi, i cili ven ne disposicjon të shkolles shumen prej 400 dinarësh.

Të vorfanit dhe sakatët, Kadri Ariši dhe Zeqir Latifi, t'etshëm për arsim, të cilet dallohen të parët në luftimin e analfabetizmit, skuqen kur të dyt dorzojne nga 100 dinarë. Ata sikur të kishin pase ma tepër, sigurisht nuk do të kurseheshin per shkollë. Këtë gja e dallojshe në fytyrat e tyne terhekëse, të cilat të lejshin me kuptue diçka që ndihej vetem në zemrat e tyne. Këtyne u dukej e paket ndihma që jepshin pse deshira për t'a ndihmue shkollën, ishte shum ma e madhe. Po sa ketai mbaruen fjalet e tyne, andej kah fundi, nxanësi i shkollës Adem Zeneli, të cilit i qeshte fëtyra prej gëzimit të madh qe ndiente, ngrihet dhe dorzon 30 dinarë. Tue i dorzue të hollat, nxanësi ne fjalë tha qe i vinte keq pse nuk kishte të holla ma tepër si i vorfun qe ishte.

Shembullin e mirë te këtyneve e ndjeku dhe pjesa tjeter e popullit tue dorëzue shumen prej 2470 dinarësh. Tue marrë parasyshë se shkollës i duheshin dhe orendit për klasë, katundarët Ramadan Fetahu, Musa Ismaili dhe disa të tjerë i nxoren prej shtepijave të tyne 150 copë drrasa dhe i vuen në disposicjon të shkolles. Populli i këtij katundi nuk kursej te japë dhe 256 orë punë vullnetare.

Dita e pare e shkolles qe nji ceremoni e kandeshme jo vetem per nxanësit, por edhe për të gjithë katundarët, të cilët muerren pjesë me enthuzjazem bashkë me fëmijt dhe mesuesin e tyne.

Tash shkolla e këtij katundi ka 163 nxanës e nxanëse të rregullt.

Shembullin e këtij katundi Tugjevc e ndoqen dhe katundarët prej Sfirces, të cilët vendosën që të ndërtojnë nji shkollë të re në katundin e tyne. Me këtë rast mblodhën si ndihmë të vullnetshme shumen prej 41000 dinarësh, 100 copë landë dhe 150 copë drrasa. Gjithashtu premtuen se do të japin dhe 300 ditë punë vullnetare.

Janë me të vertetë karakteristike vepra, puna dhe vullneti i këtyne dy katundeve, banorët e të cilave e kanë kuptue shum mirë randesin e arsimit dhe të nevojes s'edukimit të fëmijve të tyne me frymen e re të shtetit t'onë demokratik, me të drejta të bara arta nacjonale sikur të gjithë popujt tjerë, mbrenda kuadrit Federativ.

Vepra e mirë e ketyne katundeve duhet të vijohet dhe prej katundeve tjera të Krahinës s'onë, mbassi ne ketë menyrë luftojmë ma shpejt pa-dijen dhe e realizojmë Planin pesvjeçar, drejt lumnis s'onë e të brezit të ri. N'anen tjetër Pushteti populluer do t'i ndihmojë me të gjitha fuqit e tij katundet qe kane inisjativë kah e mira e përgjithshme.

Puna e dobet kulturo-arsimore ne Peje

Puna per likuidimin e analfabetizmit ne qytetin e Pejës, me gjithse i ka te gjith kushtet per mbarëveshtje, asht shum e dobët. Deri ne mbarim te fushates simbas planit asht parapa te mesoine shkrim e kendim 225 analfabete. Seksioni arsimuer i keshillit te qytetit i ka kushtue kesaj çashtjeje kujdes te madh. Ka organizue mbajtjen e themave mbi randesin e luftes kundra analfabetizmit ne te gjitha rejonet, ka caktue lokalet ku do te mbahen kurset dhe ka instalue driten ne to, u ka sigurue dru si dhe abetare, fletore e sende tjera te nevojshme. Mesuesat, me ndihmen e komisioneve, kane krye regjistrimin e analfabetve. Gjate pregatitjeve jane aftesue per udhëheqse kursesh 9 shqiptare. Por, me gjithë keto pregatitje, kurset ndiqen vetem prej 228 analfabetvet. Arsyja kryesore asht se nuk zhvilloh e lufta e duhun politike kundra atyne elementave qe e pengojne zhvillimin e kesaj fushate simbas planit. Ne qytet ka edhe keshilltarë te pushtetit populluer te cilet jo vetem nuk i dergojne ne kurse antaret analfabete te familjeve te tyne, por edhe e pengojne me dashje kryemjen e ketij planit. Keshtu ka ngia me Selim Pelen - keshilltare i pushtetit populluer, i cilit nuk i lejon bijat e veta analfabete me ndjekë kursin, tue thane se g'ola keto nejekin do fare Kursesh tjera, gja qe nuk asht e vertete. Gadi keshtu kane veprue edhe Luz Mala, Arif Spahija e bile edhe nepunësi i keshillit te qytetit Jahja Zhiqa. Keta, me qellim, nuk i lejojne gratë dhe antaret e tjere te familjes me ndjeke kurset. Ka njerez qe ne forma te ndryshme e pengojne hovin e fushates. Kursi per shqiptare asht caktue te mbahet ne shtepin e Jonuz Kap'çit, por ky nuk lejon te vendosen bankat ne shtepi dhe ka do kohe qe bankat rrine e prishen para deres se keshillit populluer te qytetit. Keshilltaret e lagjeve dhe perfaqsuesat e organizatave masovike prane komisjoneve per likuidimin e analfabetizmit nuk e kane organizue ende transportimin e druve te bleme, ka kohe qe rrine e kalben n'oborrin e shkolles fillore, ndersa mesimet neper kurse analfabetike zhvillohen ne dhoma te ftoita. Antaret e komisjoneve te rejoneve e lagjeve - perfaqsuesa t'organizatave masovike nuk marrin pjesë ne mbledhjet e komisjoneve. Per shkak te këtij mos interesimi t'organizatave te Frontit, e tane barra i ka mbete seksjonit arsimuer, i cili nuk asht ne gjendje me e zbatue fushaten pa ndihmen e ktyne organizative. S'ka asnji arsye qe fushata te mos zhvillohet simbas planit. Madje ne Pejë kushtet jane ma te favorëshme se ne çdo vend tjeter te Krahines s'one, mbasi ka mjaft arsimtarë qe duen me punue. Ne tetë mbledhjet qe ka mbajte

(Vazhdon në faqe e gjashtë)

Me udheheqsat e kurseve analfabetike

Mitrovice:

Para disa ditësh ne lokalin e shkolles fillore u-mlodhen udheheqesat e kurseve analfabetike dhe antaret e Komitetit Shqiptar te qytetit. Ne kete mbledhje mori piese dhe prokurori publik per Kosove e Metohi, shoku Ali Shykriu.

Mbas diskutimesh per permirësimin e punes se kurseve si ne kuantitet e aq ma teper ne kualitet, udheheqsave e udheheqeseve te kurseve me grate shqiptare iu nda nga nji dhurate ne te holla. Ne kete çast mori fjalen shoku Ali Shykriu tue thane midis te tjerave: "Ky nuk asht nji çast ku po shperblehet puna e mundi i juej; keto nuk mund te shperblehen kurre me te holla. Dhurata qe ju jepet nuk asht nji ndihme materiale, por nji sodiksfaksion moral. Asht nji moment historik per masat t'ona, kur sot me te gjitha energji t'ona po kontribuojme ne ngritjen e nivelit kultural te tyne". Shoku Ali theksoi gjithashtu randsin e likuidimit t'analfabetizmit ne kohe sa ma te shkurten, per t'ece me hapa ma te shpejta ne realizimin e Planit pesvjeçar, me te cilin hyjme ne socjalizem, ku nuk egziston shfrytzimi i njeriut prej njeriut.

Lufta kundra padijes asht e randë theksoi ai, sepse kemi te bajme me nji popull, ku shekuj me radhe ka qene i hedhun n'erresinen e padijes. Ne kurset analfabetike te mos kufizohemi vetem ne kalimin e shkronjave, por nji kohesisht mbas mbarimit te zhvillimit te shkronjave ne forme diskutimi te shkurten t'u japin njohuni elementare si p.sh. nga shkenca natyrore, nga ekonomija etj.etj.

Shoku Ali foli gjithashtu per perden e zeze qe pengon emancipimin e femnes s'one. Ne kete drejtim u diskutue mjaft dhe ne fund upa me vend qe ketij akcioni t'i pergjigjen ne rradhe te pare aktivistat e Front'it.

Ma ne fund shoku Ali përfundoi tue thane:, si banor i Mitrovices, deshroj qe lufta kundra atyne që pengojne emancipimin e grues te jetë e ashper, gjithashtu deshroj qe te tilla mbledhje te jene te shpeshta per te mujt me ndrrue eksperijencat ndermjet njani tjetrit e per te rrahë problema te ndyshme.

SH. VRIONI

Besimi i Stalinit ne fuqin krijuese te femnes

Perfshimja ne ndertimin e socializmit, e shtresavet ma te gjana popullore te BRSS, pra edhe te popullit te kom besinavet dikuer te shtypuna dhe te mbrapambetuna, ka qene fitorja ma e madhe e ideologjis sovjetike, — e cila i konsideron masat si krijueset e verteta te historis — mbi ideologjin borgjeze, e cila perhape gjithfare dokrrash se gjoja, masat nuk jane t'afta per te krijue vete ne te gjitha fushat e jetes. Shoku Stalin e ka demaskue karakterin reakcjonar te „teoris", qe thote se te çrytezuemit nuk mund te rrojne pa çrytezuesat. Nji nga meritat ma te randesishmet te revolucjonit proletar, ka thane shoku Stalin, asht fakti qe ay i ka dhane kesaj teorije grushtin vdeksuer".

Bashke me teorin reakcjonare raciale, Stalini e ka demaskue si duhet edhe iden — e mbjellun nga çrytezuesat, — e syperioritetit te mashkullit ne krahasim me femnen.

Si merite te madhe te Stalinit duhet me e konsiderue faktin qe ay, ne perjudhen e hovit te pare t'industrijalizimit dhe kolektivizimit, kur asht dashte me i mobilizue te gjitha fuqit puntore te popullit per zgjidhjen e problemevet ma te mdhaja, e shtroi kryekeput si duhet çashtjen e grues, çashtjen e pozites se grues, rolit jashtezakonisht te randesishem te femnavet, puntore e katundare, në jeten ekonomike dhe politiko—shoqnore; e ngriti kete çashtje ne naltesin e duhun dhe e zgjidhi ne menyre te drejte.

„Asnji levizje e madhe e te shtypunvet, ne historin e njerzimit — thote Stalini, nuk ka qene e mundeshme pa pjesmarrjen e femnavet punonjese. Grate punonjese, ma te shtypunat nder te shtypunit, nuk kane ndejte, as qe kane mujte me ndejte, kurre jashta rruges se madhe te levizjes revolucjonare. Siç dihet, lufta çlirimtare e skllavevet, ka dhane qinda e mija martire dhe heroina te mdhaja. Ne radhet e luftetarvet per çlirimin e gjysem—skllavevet ka pase mija e mija gra — punonjese. Nuk asht çudi qe levizja revolucjonare e klases puntore, ma e forta nder te gjitha levizjet revolucjonare te turmavet te shtypuna, ka terhjeke nen flamurin e vet mil'ona femna punonjese ".

„Femnat punonjese, ka thane Stalini, puntoret e katundaret, jane nji rezerve kolosale e klases puntore. Kjo rezerve perban hiq ma pak se gjymsen e popullsis. A ka me qene kjo rezerve me klasen puntore apo kundra saje—nga kjo mvaret fati i levizjes proletare, fitorja ose disfata e revolucjonit proletar, fitorja ose disfata e pushtetit proletar. Prandaj, detyra e pare e proletarjatit dhe pararojes se tij—partis komuniste, asht kjo: te zhvilloje nji lufte vendimtare per t'i shkpute femnat, puntore e katundare, nga influenca e borgjezis, per arsimin dhe organizimin politik te puntorevet dhe katundarevet nen flamurin e proletarjatit".

„Por femnat punonjese thote Stalini, nuk jane vetem rezerve. Ato mund dhe duhet te bahen, — kur klasa puntore ndjeke nji politike të drejte-armata e vertete e klases puntore, e cila operon kundra borgjezis. Me farkue nga rezerva e femnavet punonjese armaten e puntorevet dhe katundarevet, e cila operon krah per krah me armaten e madhe te Proletarjatit, — kjo asht detyra e dyte dhe vendimtare e klases puntore".

Per sa i perket rolit dhe randesis se grave ne kolhoze qe se çka ka thane Stalini ne fjalimin e mbajtun ne kongresin e pare te kolhozianevet—sulmuesa:

„Çashtja e grues ne kolhoze, — ka thane Stalini — kjo asht çashtje e randesishme, shoke. E dij se shum nder ju nuk i çmojne femnat sa duhet, e deri edhe i bajne n'asgja. Por ky asht gabim, shoke, dhe gabim i madh. Asht gabim jo vetem sepse femnat perbajne gjymesen e popullsis, por, para se gjithash, asht gabim sepse levizja kolhoziane ka ngrite nder detyra udheheqese nji seri te tane femnash te perparueme dhe t'afta. Shiqoni kongresin, perbamjen e tij, dhe keni me pa se femnat nuk jane tashma te mbrapambetuna, se tashma kahere ndodhen ne radhet e ma te perparuemvet. Femnat ne kolhozet jane nji fuqi e madhe. Me e mbajte ket fuqi inaktive, kjo don me thane me ba nji krim. Na e kemi per detyre qe nder kolhoze t'u japim femnavet nji vend nderi dhe t'a vejme ket force ne levizje".

„Persa u perket vet kolhozianevet — thote Stalini—ato duhet t'a kene ne mend fuqin dhe randesin e kolhozit per femnat, duhet t'a kene nder mend se vetem nder kolhoze kane mundesin te barazohen me mashkujt. Pa kolhoze-mosbarazi, nder kolhoze barazi si drejtash. Shoqet kolhoziane te t'a kene këte nder mend dhe te t'a rujne sistemin kolhozian si driten e syvet te vet".

Lajme nga bota e jashtme

„Për paqë të shëndoshë, për Demokraci popullore“

PER BASHKIMIN E KLASES PUNTORE

Në perjudhën e mbasluftës, kur imperjalizmi amerikan, tue shkelë lirin dhe pamvarsin kombëtare të popujve, përpiqet me i realizue planet e veta të sundimit të botës, klasa puntore, sikur edhe në kohen e luftës antifashiste, asht luftëtarja ma besnike dhe ma e vendosuna për demokraci, për lirin dhe sovranitetin kombtar të Vendeve të saja. Klasa puntore, nën udhëheqjen e partive komuniste, organizon dhe bashkon të gjitha fuqit demokratike e patriotike të popujve, i mobilizon ato për luftën kundra planeve imperjaliste reakcionare.

Prandaj asht krejt e natyrshme që imperialistat dhe agjentat e tyne-socjalistat e djathtë- përpiqen t'i përçajnë, pikë së pari, forcat e klasës puntore e kësisoji, t'a dobësojnë kampin demokratik.

T'armatosun me Deklaratën e konsultës së nandë partive komuniste në Poloni, komunistat kanë korrë suksese të reja në luftën për bashkimin e klasës puntore.

Më inisjativë të përbashkët të Partis Komuniste dhe asaj socjaliste, n'Itali po merr përpjestime dita ditës ma të mdhaja lëvizja për formimin e Frontit populluer të luftës për paqë, liri per pamvarësi. Uniteti i akcjonit i të dy partive puntore te Rumanisë, partina të cilat shkojnë kah shkrimja organike, kontribuoi në këthimin e Vendit në nji republikë popullore sovrane. Kongresi i dhetorit i partisë socjaliste poloneze, ku u-vendos përforcimi dhe zgjanimi i frontit t'unjisuem, përfundoi me demostratën e përbashkët madhështore të partis socjaliste dhe asajë puntore poloneze kundra atakimeve t'imperjalistave anglo-amerikanë kundra kufijve prendimorë të Polonisë. Në Francë, shumica dërmuese e klasës puntore, në krye me Partin Komuniste, u-ban nji luftë të rrebtë intrigave dhe dallavereve të Blumit dhe Zhuos, të cilët, mbas urdhnit të zotnijve të tyne amerikanë, përpiqen me i minue dhe përça sindikatat. Me pjesëmarrjen aktive të partisë s'unijisueme socjaliste të gjermanis, po zgjanohet lëvizja e kongresit të përgjithshëm populluer gjerman kundra planeve anglo-amerikane, që kanë për qëllim coptimin dhe skllavërin e Gjermanis, plane për të cilat Shumaherat e ndryshëm përpiqen me sa fuqi kanë.

Procesi i unjifikimit të klasës puntore ka shkue përpara sidomos në vendet e demokracis së re. Kjo asht gja krejt e natyrshme.

Uniteti i klases puntore në vendet e demokracisë popullore u-farkue dhe u-forcue në luftën kundra anmiqëve të përbetuem të pushtetit populluer, të cilët ngjallen urrejtjen dhe anmiqësin për komunistat dhe Bashkimin Sovjetik. Arçishevskat, Puzhakovat, Petreskuat, Pejerat, Topalloviqat dhe Lulqevat e ndryshëm, të cilët kanë marrë pjesë aktive në luftën e fshehet fashiste kundra demokracisë popullore, kanë organizue spijunazhin dhe akcjonet diversante, të gjithë këta lëvizja demokratike i hjedhë jashtë me pjesëmarrjen aktive edhe të vet puntorve socjalista.

Në Jugosllavi, e në kohën e fundit edhe në Bullgari, asht realizue uniteti i plotë i klasës puntore në radhet e fronteve popullore. Në Vendet e tjera — Poloni, Rumani Hungari, Çekosllovaki - bloku i komunista dhe socjalistave kërkon bazen për unjisimin e fuqive të klasës puntore.

Në të gjitha Vendet e demokracis së re asht krijue, ne bazë t'unitetit, nji lëvizje e fuqishme sindikale, e cila paraqet nji faktor me randesi për zhvillimin e këtyne Vendeve.

Klasa puntore, tue i bashkue dhe shtrëngue radhët e veta, ka lidhë aleancë të fortë me katundarinë dhe intiligjencen puntore. Ajo asht vue në ballë të popullit, që t'a riorganizojë jetën politike dhe ekonomike në bazë të parimeve të demokratizmit dhe sovranitetit kombëtar të vërtetë.

Në saje të bashkimit dita ditës ma të madh të popullit puntor, bashkim i cili e ka gjetë shprehjen e vet në Frontin populluer dhe ne blloqet e partive demokratike, partit komuniste të këtyne vendeve kanë qenë ne gjendje që, në luftën e rrebtë kundra reaksionit, t'i mobilizojnë turmat popullore për plotësimin e planeve të rindërtimit dhe ndertimit ekonomik të vendeve të veta, çka njikohësisht siguron ngritjen gjithnji ma të naltë të nivelit jetësuer të popullit. Uniteti i klasës puntore dhe i të gjitha shtresave puntore e përforcon pushtetin populluer, e banë të mundëshme mprojtjen e suksesëshme të sovranitetit dhe pamvarësis kombtare nga atakimet e imperialistave anglo-amerikanë.

Faktet tregojnë se sa ma e vendosun dhe konsekuente te jetë lufta kundra anmiqëve te bashkimit, aq ma mirë përforcohet fronti i unjisuem. Tradita te reja të luftës dhe punës së përbashkët po forcohen, ato e nderlidhin ngusht bashkimin luftarak të qinda mija puntorve-komunista e socjalista,—dhe po i hjedhin poshtë dita dites traditat e vjetra të mos-besimit reciprok, të cilat i kanë mbjellë ndër ta vite me radhë socjalistat e djathtë-agjenta të borgjezisë. Vetëm tue iu-përmbajtë frontit t'unjisuem dhe tue u-spastrue nga traditat e këqija të socjaldemokratizmit, partinat socjaliste mund t'i përforçojnë radhet e veta. Këtë na tregon rroli dhe randësija e partive socjaliste të Polonis dhe Italis që punojnë në kushte tëndryshme dhe po e hjedhin poshtë, me punë, legjenden e rrejshme të socjalistave të djathtë se gjoja fronti i unjisuem i damton partinat socjaliste, i pakson forcat e tyne.

Në saje të pushtetit populluer dhe përparimit drejt socjalizmit, po krijohen para-kushte për herë e ma të shumta për çrranjosjen e influencës së borgjezis dhe ideologjisë së sajë reakcjonare në klasën puntore. Shembulli i Rumanis na tregon se thellimi i bashkpunimit në mes të partive puntore dhe afrimi i tyne idelogjik çon drejtë shkrimjes organike të partive puntore në bazen e marksizëm-lenjinizmit.

Lufta e kampit demokratik kundra imperialistave i detyron partinat socjaliste t'a përcaktojnë qëndrimin e tyne ndaj kësaj lufte dhe i ashpërson mos-marrëveshtjet në mes të tyne.

Rrolin si agjenta amerikanë e luejnë Bevinat, Blumat, Saragatat e Shumaherat e ndryshëm. Marrëveshtjen që, de fakto, e kanë lidhë me Shumanin e de Golin në Francë, me Çerçilin n'Angli, me de Gasperin n'Itali, ata përpiqen me e mshefë me „teorinë“ e s'ashtuquejtunes „fuqi të tretë“.

Socjalistat e djathtë, të cilët bajnë be se nuk dishrojnë të bashkohen me asnjenën nga të dyja fuqitë, kaherë e kanë zgjedhë kampin e reakcionit imperjalist, janë bâ shërbëtorë besnikë t'imperializmit.

Teorija e „fuqis së tretë“ nuk asht e re. Ajo nuk asht tjetër veçse nji Varjante (qeshit) e teorisë së mirënjoftun të „së keqes ma të vogël“, të cilen socjal demokratët e djathtë e kanë përdorë për t'ia çelë Hitlerit rrugën e ardhjes në pushtet, për t'a pregatitë dhe justifikue Mynhenin, me të cilin filloi lufta e dytë botnore.

Teorijn e „fuqis së tretë“ asht nji blof politik, i maskuem keq, i cili ka për qëllim me e lehtësue ekspansjonin e imperialistave amerikanë dhe përziemjen e tyne dita ditës ma brutale në politikën e jashtme dhe të mbrendëshme të vendeve që Bevinat dhe Blumat e ndryshëm i kanë lidhë mbas qerres së dollarit. Ajo ka për qëllim me e „justifikue“ pjesmarrëjen aktive të socjalistave të djathtë në pregatitjen dhe realizimin e planeve të reja për plaçkitjen e popullit puntor, me justifikue përçamjen e sindikatave dhe shpifjen e poshtër kundra Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të demokracis së re.

Kuptimin e vërtetë të „fuqis së tretë“ e tregon „socjalisti“ Mok, që urdhënoi me hapë zjarr në puntorë grevista francez. Demokratet dhe petriotet e vërtetë po e kuptojnë kjartazi se pa luftue vendimtarisht kundra teoris dhe praktikës së të famshmes „fuqi të tretë“, nuk mun të luftohet me sukses kundra imperjalistave. Elementat demokratë të të gjitha Vendeve e shofin gjithnji ma mirë se teorija e „fuqis së tretë“ ka për qëllim me luejt nji rrol provokues përçaes. Lidrat (shefat) e partive socjaliste t'Italis dhe Polonis-Neni e Cirankjeviq-në fjalmet e tyne kanë thekësue se teorija e „fuqis së tretë“ çon ujë vetëm në mulli t'imperjalistave dhe i kanë ftue të gjithë socjalistat e sinqertë të bashkohen me komunistat kundra „lumnipruesave“ imperjalista.

Idenat e Deklaratës së konsultës së nandë partive komuniste dhe eksperijenca e fitueme nga bashkimi, po përvehtësohen dita ditës ma tepër nga turmat punonjëse, nga të gjithë ata që e kanë në zemër çashtjen e nderit dhe pamvarsis s'atdheut të vet. Me gjithë punën trathtare të socjalistave të djathtë, puntorët francez, në luftën greviste, treguen kompaktësin (bashkimin e fortë) dhe shkallën e tyne mjaft të naltë t'organizimit. Ata nuk lejojnë kursesi që të futen në manevrat përçaese të lidërve të djathtë sindikal. Sa e sa organizata lokaje të tred-unjoneve dhe partis laburiste n'Angli e ngrejnë zanin e tyne të protestës kundra „fushatës së kryqzatave“, që kanë organizue Bevinat dhe Filipsat e ndryshëm kundra komunistave. Në SH.B.A. po shtohet rezistenca e masave sindikale kundra përkrahjes që i japin krenet e korumpuem sindikal „planit Marshal“ si dhe kundra perpjekjeve sistematike që bajnë ata për t'i përça radhët e lëvizjes sindikale europjane.

Luftëtare të vërteta për unitetin e klasës puntore dhe të të gjitha fuqinave demokratike janë partinat komuniste. Ato janë të vetëdijshme se „qe të shpartallohet dhe të falimentojë kryekput plani i agresjonit imperjalist, nevojiten përpjekjet e të gjitha fuqive demokratike dhe anti-impërjaliste t' Europës“. Partinat komuniste janë gjithashtu kryekput të vetëdijshme se atyne u takon rroli i veçantë historik-me u vue në ballë të rezistences kundra planit amerikan të skllavërimit t' Europës, me i demaskue si duhet të gjithë ndihmësat e imperijalizmit amerikan, me e përforcue unitetin e klases puntore.

Marrëveshtja Rumuno-Hungareze

Pakti i bashkpunimit, ndihmës reciproke dhe miqësis, që u nënshkrue në mes të Republikes Popullore të Rumanis dhe Republikes së Hungaris, hapë perspektiva të mira për zhvillimin e përparimin e popujvet të të dyja Vendevet, e për sigurimin e kufijve të këtyne dhe, njikohësisht, asht nji kontribut me randësi në përforcimin e paqes n'Europen Jug-lindore dhe në botë, përgjithësisht.

Populli rumun dhe ay hungarez kanë nji eksperijencë të hidhët nga e kaluemja. Imperijalistat e prendimit e, mandej, imperijalistat giermanë, me ndihmen e reakcjonit të mbrendeshem, kanë ba çmos, sidoemos në lidhje me Transilvanin, për t'a nxitë dhe ndezë urrejtjen shoviniste në mes të këtyne dy popujvet fqij, për të muejtë me i çfrytëzue dhe kolonizue ma lehtë këto vende.

Tashti nën kushtet e vendosjes së demokracis popullore në Rumani dhe Hungeri, Transilvanija, nga mollë grindjeje, asht kthye në nji urë bashkimi dhe miqësimi dita dites ma te ngushtë ne mes të te dyja Vendevet. Imperialistat nuk muejne ma kurr me luejtë me fatin e popullit rumun dhe atij hungarez. Këte e vërteton edhe marreveshtja per bashkpunimin kultoral, e nenshkrueme tash vone, marreveshtje e cila i siguron pakices hungareze zhvillimin e plote kultural e kombetar.

Marreveshtja rumuno-hungareze u djegë imperialistavet. Natyrisht, sepse ketyne nuk u interesson qe populli rumun dhe hungarez te bashkpunojne vllaznisht dhe te luftojne per paqe. Imperjalistat do te dishrojshin me i kthye 'ne pushtet klikat e vjetra reakcjonare ne keto vende. Por, kane kalue ato kohna kur imperjalistat kane qenë zotën ne kete pjese t'Europes, kur, me ndihmen e veglave te tyne te mbrendeshme, kane muejt me e çue ne vend moton e vet: „daj e sundo!“. Popujt e pellgut danubjan, sikurse ata te shteteve demokratike popullore te Ballkanit, kane hye ne rrugen e bashkpunimit te ngushte, rrugen e ardhmenis se vet te lumtun.

Ky bashkpunim ne mes te Rumanis dhe Hungaris asht i mundeshem ne saje te faktit qe ato drejtohen nga qeverina demokratike, te cilat jane shprehja e vullnetit te popujve te vet.

Ne kete pakt çfaqet vendosja e ngushte e te dy popujvet me kontribue se bashku ne mprojtjen e paqes demokratike, me e ndihmue njeni tjetrin ne sigurimin dhe ne rase nevoje, mprojtjen e pamvarsis kombetare nga çdo rrezik qe mund t'u kercnohej, me perforcue lidhjet miqsore me shtetet demokratike popullore fqij.

Me kete marreveshtje, populli rumun dhe ay hungarez u a dhane edhe nji pergjegje te mire imperialistavet amerikane dhe nxitesavet te luftes që, ku te mueine, e shkelin pamvarsin kombetare te popujvet.

(Vijon nga faqja e pestë)

Komisjoni i qytetit per likuidimin e analfabetizmit, jane caktue detyrat konkrete, ndersa ata qe i kane marre persiper keto detyra, vetem kane dhane premtime te thata e fjalë tjeter.

Per t'a realizue planin e likuidimit t'analfabetizmit, ne rend te pare duhen demaskue neper konferenca te gjithe elementat qe mbajne qendrim anmiqsuer ndaj kesaj fushate. Mandej, organizatat e Frontit duhet te punojne me te gjitha fuqit dhe me serjozitetin ma te madh per t'i perfshi ne kurs te gjithe analfabetet, e sidomos shqiptaret Komiteti shqiptar, i cili nuk i ka kushtue kujdes te mjaftueshem kesaj çashtjeje, tash e mbrapa duhet te baje çmos, si e si te kryhet e te kapercehet plani ne kete fushate dhe te mos lejoje qe disa individe t'a pengojne zbatimin e tij.

Edhe ne format tjera t'arsimit populluer puna asht e dobet. Deri sa ne vitin e kaluem ne ket qytet kane punue ma teper se 15 kurse te nalta arsimore, sot punojne vetem dy kurse me 25 veta. Duhet theksue sidomos qendrimi i pa shpirte ndaj bibljotekes dhe salles se leximit e cila nuk egziston ma ne ket qytet. Librat e sigurueme per ket bibljoteke rrijne ne keshillin e Frontit Populluer te Rrethit- jane te siguruemе mirë (!) - te mbulueme me nji shtrese te trashë pluhuri.

(Vijon nga faqja e dyte)

3. Të përforcohen lidhjet në mes të këshillave të Frontit, me u udihmue qe të naltësohen dhe të bahen udhëheqje të verteta të turmavet popullore.

4. Me vendosë evidencen e saktë dhe të qendrueshme t'antarvet si edhe evidencen e plotësimit te të gjitha detyrevet dhe detyrimevet të

5) Në punën e organizatavet themelore te Frontit Populluer duhet te perfshihen pa tjeter antarët e Frontit Populluer t'organizuem në sindikata dhe me i aktivizue këta sa ma shum.

6. Me iu përveshë në mënyren ma të vendosun spastrimit të Frontit nga të gjithë elementat anmiqë që e pengojnë punen dhe zbatimin e politikës së Frontit Populluer,

7. Me hartue buxhete vjetore reale të hymjes e të dalunash dhe me ia paraqitë Këshillit Krahinuer të Frontit Populluer.

8. Me i kushtue kujdes të posaçëm çashtjes së pagimit të rregullt t'antarsis së Frontit në kët vit,

9. Me formue fondin financjar për rindertimin e ndertimin. Votimet e aferme për Këshillin e Frontit Populluer duhet të popullarizohen, në mënyrë ma të gjanë, ato duhet të pregatiten e t'organizohen si e si të kryhen me sukses, kështu që këshillat e reja të cilat do të zgjidhën të jenë t'aftë dhe në gjendje me i mobilizue të gjithë antarët e Frontit për plotësimin me sukses të të gjitha detyrave të Frontit Populluer.

Botim i Këshillit Krahinuer te Frontit populluer; Shtypshkroja Krahinore „PROGRES“
Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i cekut 38-30450